

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Punë**

**PËR ARGUMENTIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURËS NË NJË KONTRATË**

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”**, me objekt: **“Ndërtimi i tregut për shitje me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore (Tirana Agrikulturë)- Faza III-të”**.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **645,822,348.16** (gjashtëqind e dyzet e pesë milion e tetëqind e njëzet e dy mijë e treqind e dyzet e tetë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **6,440,190.95 Euro pa TVSH**.

**\*Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 27 / 06 / 2024 – 28 / 06 / 2024 është 100.28 Lekë/Euro.**

**Në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 39, pika 1 përcaktohet se:**

*“Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.  
Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”*

**Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Kreu V, Neni 42, pika 1 dhe 2 përcaktohet se:**

*“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.  
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”*

Për sa më lart, nëpërmjet këtij Procesverbali argumentojmë se:

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë ka vendosur të zhvillojë procedurën e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar pa e ndarë në lote, pasi referuar Preventivit të punimeve për objektin: **“Ndërtimi i tregut për shitje me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore (Tirana Agrikulturë)- Faza III-të”**, AK e ka të pamundur teknikisht ndarjen e këtij objekti në lote të veçantë.

Gjithashtu sqarojmë se referuar dokumentacionit teknik pjesë e DST (i cili është hartuar nga Projektuesi i shpallur fitues), konkretisht Raportit teknik, Specifikimeve Teknike dhe Preventivit

të punimeve, qartazi përcaktohet se proceset e punës për këtë objekt janë të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrën dhe AK e ka të pamundur të përcaktojë paraprakisht se cilat volume duhet t'i nënshtrohen procesit të ndarjes.

Në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 14, parashikohet se:

*“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.*

*2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.*

*Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.*

*3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”*

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, citohet se:

*“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

*2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*

*3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*

Për sa më lart, legjislacioni i prokurimit publik, ndër të tjera ka parashikuar dhe mundësinë për Operatorët ekonomik (të cilën nuk plotësojnë kërkesat teknike apo ekonomike veçmas) që të bashkohen me shoqëri të tjera me qëllim përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në DST.

Në këtë rast legjislacioni i prokurimit publik nuk kërkon një formë të veçantë ligjore të bashkimit të shoqërive duke nxitur në këtë mënyrë dhe pjesmarrjen e Operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit.

Për sa më lart, mos ndarja në lote e procedurës së prokurimit, nuk e kufizon tregun, pasi kriteret e hartuara ne DST janë gjithëpërfshirëse, si dhe termat e referencës janë hartuar në mënyrë të tillë që t'u jepet hapësirë dhe mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për tu bërë pjesë e procedurës së prokurimit.